
SPECIFIKIME TEKNIKE

“Rehabilitimi urban i
rrugëve në disa lagje të
qytetit Korçë”.





Tabela e Përmbajtjes

1.	KËRKESA TË PËRGJITHSHME.....	4
1.1.	Parathënie.....	4
1.2.	Dokumentat e kontratës	4
1.3.	Referencat	4
1.4.	Njësitë	4
1.5.	Kushtet atmosferike dhe përmytjet	4
1.6.	Pastrimi përfundimtar i zonës	4
1.7.	Ruajtja e shenjave topografike	5
1.8.	Transporti dhe magazinimi i materialeve.....	5
1.9.	Provat laboratorike	5
1.10.	Kampionet e provave	6
1.11.	Çertifikatat e Provës.....	6
1.12.	Zëvendësimet e materialeve.....	6
1.13.	Kryerja e Punimeve jo në Prani të Ujit	7
1.14.	Mbrojta e shërbimeve publike ekzistuese	7
1.15.	Punë e Kryer jo-mirë.....	7
2.	KONTROLLI I CILËSISË	7
2.1.	Përshkrimi	7
2.2.	Testet e çertifikuara laboratorike	8
2.3.	Çertifikimet e fabrikuesve.....	8
2.4.	Njoftimi për mos përfundim	8
3.	MENAXHIMI MJEDISOR	8
3.1.	Përshkrimi	8
3.2.	Rivendosja e bimësisë (ribimësia)	9
3.3.	Mbeturinat e vajit, karburantit dhe materialeve bituminoze	9
3.4.	Pluhuri.....	9
3.5.	Ngarkimi e materialeve/mbulimi	9
3.6.	Emetimet	9
3.7.	Nivelet e zhurmave	9
3.8.	Vendosja e kampeve, hedhja e mbeturinave të kampit	9
3.9.	Habitatet e papërshtatshme/të padëshirueshme.....	9
3.10.	Materiale të rrezikshme.....	9
3.11.	Bimësia	10
3.12.	Aksesi në prona.....	10
4.	PASTRIMI I KANTIERIT.....	10
4.1.	Hyrje	10
4.2.	Kërkesa të Përgjithshme.....	10
4.3.	Mbrojtja e elementëve që janë projektuar të rrijnë përsëri.....	11
4.4.	Grumbullimi i materialeve të pastruara.....	11
5.	SHKATERRIMET, PRISHJET, ÇMONTIMI DHE HEQJET	12
5.1.	Hyrje	12
5.2.	Hedhja e materialeve.....	12
6.	PUNIMET NË RRUGË	12
6.1.	Qëllimi	12
6.2.	Gërmim dheu seksion i detyruar:	12
6.3.	Ndërtim bankina anësore:	12
6.4.	Gërmim dheu seksion i lirë:	12
6.5.	Mbushje me material shkëmbor:	12
6.6.	Shtresë zhavori nën kunetë:	13
6.7.	Beton M-200 për kunetë:	13
6.8.	F.V Bordura betoni të Parapregatitura 15x30x100 cm:	13
6.9.	Mure betoni M-150:	13
6.10.	Beton M-100 nën bordura e tubat e betonit :	13

Punime Shtresash në Rrugë	14
6.11. Shtresë çakulli makinerie, 15cm/20cm , gran.10/60 mm, 5/50 mm:	14
6.12. Shtresë stabilizanti 1x10cm, gran.5/35mm:	14
6.13. Shtresë binderi me trashësi 4 cm:	14
6.14. Shtresë asfaltobetoni me trashësi 4 cm:	15
7. PUNIMET PER LINJAT REZERVE	17
7.1. Te pergjithshme	17
7.2. Shtrimi ne kanal	17
7.3. Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdorimi i sakte i tyre	18
7.4. Instruksionet e montimit	18
7.5. Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone	18
7.6. Germimi	18
7.7. Ndertimi i pusetave	19
7.8. Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet	19
7.9. Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat.....	19
8. PLLAKAT.....	19
8.1. Të përgjithshme	19
8.2. Materialet - pllaka betoni vetështrënguese.....	20
8.3. Shtrimi.....	20
8.4. Provat	20
8.5. Matjet dhe pagesat	20
9. BETONI	21
9.1. Përshkrim	21
9.2. Materialet për Beton	21
10. BORDURAT	22
10.1. Pershkrim	22
10.2. Materialet per bordurat.....	22
11. PUNIME NË NDËRTESA.....	22
11.1. Suvatim mur i jashtëm	23
11.2. Lyerje mure jashtë me çimentokroma.....	23



1. KËRKESA TË PËRGJITHSHME

1.1. Parathënie

Këto kontrata do të administrohen në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Paragrafet në këtë kapitull janë plotësuese të detajeve të dhëna në Kushtet e Kontratës

1.2. Dokumentat e kontratës

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet e treguara në Vizatime, Grafikë, Preventiva ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve apo mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për punë të pakënaqshme. Sipërmarrësi do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

Rendi mbizotërues i dokumentave do të jetë si më poshtë:

Oferta

Kushtet e Kontratës

Specifikimet e Veçanta

Specifikimet e Përgjithshme

Vizatime Projekti

Preventivi (Tabela e Volumeve)

1.3. Referencat

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Sidoqoftë Sipërmarrësi për standardet që ai mendon të përdorë duhet më parë të bjerë dakord me Supervizorin përpara fillimit të punimeve.

1.4. Njësitë

Në përgjithësi, dokumentat e kontratës dhe specifikimet teknike janë hartuar duke përdorur sistemin metrik ndërkombëtar (SI) të njësive. Në këtë specifikim përdoren shkurtime të mëposhtme:

Njësitë	Shkurtime
Milimetër	mm
Metër (linear, katror, kub)	m, m ² , m ³
Numër	secili
Diametër	D
Orë	h
Litra	L
Mega Pascal	MPa
Newton për milimetër katror	N/mm ²
Ton	t

1.5. Kushtet atmosferike dhe përmbytjet

Do të merret si e mirëqenë që Sipërmarrësi gjatë përgatitjes së ofertës së tij do të ketë marrë parasysh të gjitha kushtet e mundshme atmosferike dhe rastet e përmbytjeve në kohën e përfundimit si dhe gjatë Punimeve të Përherëshme dhe të Përkohshme. Sipërmarrësit nuk i takon asnjë pagesë shtesë si pasojë e ndodhjes, vazhdimësisë apo efektit të erërave të forta, borës, acarit, shirave dhe përmbytjeve, temperaturave apo lagështirës apo si pasojë e kushteve të tjera meteorologjike apo hidrologjike.

1.6. Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi, me shpenzimet e tij, duhet të

pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohshme të çdo lloji dhe të lerë sheshin e tërë dhe veprat, të pastra dhe në kondita të pranueshme. Pagesa përfundimtare e Kontratës do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Supervizori i Punimeve.

1.7. Ruajtja e shenjave topografike

Sipërmarrësi duhet të gjejë dhe aty ku është e mundur të ruaje apo edhe të rivendosë të gjitha shenjat topografike. Në ato raste kur shenjat topografike do të shkatërrohen, Sipërmarrësi do t'i referojë ato me saktësi në shenjat topografike të përhershme prej betoni përpara fillimit të punimeve. Të gjitha këto do të bëhen me shpenzimet Sipërmarrësit.

1.8. Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipërmarrësi do të behet me makina të përshtatshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme për ti mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion për tu kontrolluar nga Supervizori i Punimeve në çdo kohë.

1.9. Provat laboratorike

Ky seksion përfaqëson procedurat e kryerjes së provave për materialet me qëllim përputhshmërinë me kërkesat e Specifikimeve.

Supervizori mund të ekzaminojë dhe mund të kërkojë testimin e çdo materiali apo malli që kërkohet të përdoret gjatë Punimeve.

Sipërmarrësi do t'i sigurojë Supervizorit të gjitha lehtësitë, asistencën, krahun e punës dhe pajisjet që nevojiten për ekzaminimin, testimin, peshimin apo analizimin e të gjithë këtyre materialeve apo mallrave.

Kontraktori do të përgatisë dhe sigurojë testimin e materialeve dhe mallrave me kërkesën e Supervizorit.

Pavarësisht nga testet që mund të jenë bërë jashtë Kantierit, Supervizori ka të drejtë të bëjë prova të tjera të mëtejshme të çfarëdo materiali apo malli në Kantier, si edhe ka të drejtën të mos pranojë ato materiale dhe mallra që nuk e kalojnë provën në Kantier.

Programi i Sipërmarrësit duhet të sigurojë kohën e duhur për testimin e materialeve. Nuk do të pranohet asnjë ankesë (kërkesë për kompensim) për vonesa apo kosto shtesë si pasojë e sa më sipër.

Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do të kryhen provat e mëposhtme:

Përmbajtja e Ujit

Densiteti Specifik

Indeksi i Plasticitetit

Densiteti në gjendje të thatë (Metoda e Zëvendësimit me Rërë)

Shpërndarja Sipas Madhësisë së Grimeve ose Granulometria (Sitja) Proktori i Modifikuar dhe Normal

Provat e Betonit (Thërmimi i Kampioneve)

Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do të behën në përputhje me metodat standarde shqiptare ose me të tjera ndërkombëtare të aprovuara.

Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marrjes së kampioneve do të jetë siç është specifikuar në metodat e aplikueshme të marrjes së kampioneve dhe të kryerjes së provave ose siç udhëzohet nga Supervizori i Punimeve.

Frekuenca e kryerjes së provave do të përputhet me treguesit në Specifikimet Teknike dhe nëse nuk

gjendet atje, do të jepet nga Supervizori i Punimeve. Marrja e ndonjë kampioni shtesë mund të udhëzohet nga Supervizori i Punimeve.

Enë të tilla si çanta, kova e të tjera, do të jepen nga Sipërmarrësi. Marrja e kampioneve do të kryhet nga Sipërmarrësi në vendet dhe periudhat që udhëzon Supervizori i Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre në laborator do të bëhet nga Sipërmarrësi.

Ndërprerja e Punimeve

Ndërprerja e punimeve për arsye të marrjes së kampioneve do të përfshihet në grafikun e punimeve të Sipërmarrësit. Nuk do të pranohet asnjë ankesë nga ndërprerja e punimeve, për shkak të marrjes së kampioneve.

Provat në laborator, do të bëhen në një kohë të përshtatshme me metodën e përkthuar.

Provat e Kryera nga Sipërmarrësi

Për arsye krahasimi, Sipërmarrësi është i lirë të kryejë vetë ndonjë prej provave. Rezultatet e provave të tilla do të pranohen vetëm kur të kryhen në një laborator të aprovuar me shkrim nga Supervizori i Punimeve. Të gjitha shpenzimet e provave të tilla pavarësisht se nga vijnë rezultatet do të mbulohen nga Sipërmarrësi.

1.10. Kampionet e provave

Përveç dispozitave të veçanta të përfshira këtu për zgjedhjen për provë dhe testimin e materialeve, Sipërmarrësi do t'i dorëzojë Supervizorit, sipas kërkesës së tij, ekzemplarë të këtyre materialeve apo mallrave të cilat Sipërmarrësi propozon të përdorë apo verë në punë për Punimet e tij. Këto ekzemplare, në rast se aprovohen, do të mbahen nga Supervizori dhe asnjë lloj tjetër materiali apo malli i ndryshëm nga ai që i është dorëzuar Supervizorit nuk do të përdoret për Punimet e Përhershme, vetëm në rast se për këto ekzemplare Sipërmarrësi ka aprovimin me shkrim të Supervizorit. Pavarësisht nga aprovimi i Supervizorit, vetë Sipërmarrësi është plotësisht përgjegjës për cilësinë e materialeve dhe të mallrave të furnizuara. Supervizori mund të mos pranojë çfarëdo materiali apo malli që në mendimin e tij është i një cilësie më të dobët nga ajo e ekzemplarit që ka aprovuar më parë dhe Sipërmarrësi do t'i heqë menjëherë ato materiale apo mallra nga kantieri dhe do të sigurojë mallra dhe materiale të tjera që do të gjejnë aprovimin e Supervizorit me shpenzimet e tij (Sipërmarrësit).

1.11. Çertifikatat e Provës

Në rast se Supervizori nuk i ka inspektuar Çertifikatat e materialeve apo mallrave në vendin e prodhimit të tyre, Sipërmarrësi do të marrë Çertifikatat e Provës nga Furnitori i këtyre mallrave dhe do t'ia dërgojë ato Supervizorit. Këto çertifikata vërtetojnë që materialet dhe mallrat për të cilat bëhet fjalë janë provuar në përputhje me kërkesat e Specifikimeve dhe do të japin rezultatet e të gjitha provave të kryera.

Sipërmarrësi do të sigurojë pajisjet/mjetet e përshtatshme për identifikimin e materialeve dhe mallrave që do të dorëzohen në Kantier me Çertifikatat korensponduese.

Të gjitha materialet e furnizuara për përdorim gjatë Punimeve duhet të jenë brenda tolerancave të specifikuara, në cilësinë e ekzemplarëve të aprovuar që do të mbahen në zyrën e Supervizorit deri në përfundimin e Kontratës.

1.12. Zëvendësimet e materialeve

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara në Dokumentin e Kontratës do të bëhet vetëm me aprovimin e Supervizorit të Punimeve nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit. Që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë, në formën e kuotimit të çertifikuar dhe të datës së garancisë të dorëzimit nga furnizuesit e të dy materialeve, si të materialit të specifikuar ashtu edhe të atij që propozohet të ndryshohet.

1.13. Kryerja e Punimeve jo në Prani të Ujit

Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në Kontratë, të gjitha Punimet do të kryhen në mungesën e plotë të prezencës së ujit dhe nuk do të lejohet të depërtohen nga uji që mund të vijë nga çfarëdo lloj burimi.

1.14. Mbrojta e shërbimeve publike ekzistuese

Sipërmarrësi duhet të dijë pozicionin e të gjitha shërbimeve ekzistuese si kullimet e ujërave sipërfqësore, kabllot për elektricitetin dhe telefoninë, shtyllat e ndriçimit, tubacionet kryesore të ujërave etj. para se të fillojë ndonjë gërmim apo punim tjetër që mund të prekë shërbimet ekzistuese. Skicat e kontratës tregojnë vendin e shërbimeve publike ekzistuese. Informacioni i dhënë në këto skica tregon vetëm vendndodhjen e përafërt të tyre. Sipërmarrësi së bashku me një përfaqësues të agjencive të shërbimeve do të verifikojë ekzistencën dhe vendndodhjet e sakta të të gjithë shërbimeve publike të prekura nga punimet duke përfshirë, por pa kufizim:

Tubacionet kryesore të ujit

Kabllot mbitokësore me voltazh të mesëm dhe linjat e shtyllës që lidhen me këto

Kabllot nëntokësore me voltazh të mesëm

Nënstacionet dhe kapanxhat elektrike

Kabllot telefonike mbitokësore dhe linjat e shtyllës lidhur me këto

Kabllot telefonike nëntokësore

Kutitë telefonike dhe kutitë e komutatorit

Pajisje të tjera të ndryshme siç drejtohet nga Supervizori i objektit

Sipërmarrësi do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim të punimeve ekzistuese apo shërbimeve dhe do të dëmshpërblejë punëdhënësin kundrejt çdo ankese lidhur me këtë (duke përfshirë edhe dëmtimet pasuese). Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për ricaktimin e çdo shërbimi të prekur në këtë mënyrë.

Kujdes i veçantë duhet të ushtrohet në gërmimin, rimbushjen dhe në bërjen kompakte të materialeve afër tubacioneve kryesore, kabllave etj. Kujdesi i Sipërmarrësit i kushtohet rregullores që është në fuqi në Shqipëri në lidhje me boshllëqet/hapësirat e sigurisë së punimeve nga kabllot që kanë voltazhe të ndryshme për veprime që do të kryhen afër linjave mbitokësore të energjisë.

Pavarësisht nga kërkesat e mësipërme dhe pa pakësuar përgjegjësinë e Sipërmarrësit, Sipërmarrësi do të informojë Supervizorin e objektit menjëherë nëse ekspozohet, vendoset apo dëmtohet ndonjë punim apo shërbim ekzistues. Të gjitha punimet që duhet të kryhen për të korrigjuar ndonjë dëmtim të shkaktuar tek shërbimet ekzistuese, do të bëhen sipas pëlqimit të agjencisë përkatëse të shërbimit apo supervizorit të objektit dhe me shpenzimet e Sipërmarrësit. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për rregullimin/sistemimin, në koordinim me autoritetin e duhur, sapo të njihet kërkesa për lëvizjen apo ndryshimin e shërbimeve qoftë për punime të përkohshme apo të përhershme. Këto mund të përfshijnë energjinë, linjat telefonike, tubacione kryesore të ujit dhe kanale kulluese sipërfaqësore të ujit. Sistemimet për ndonjë zhvendosje apo ndryshim do të jenë subjekt i aprovimit të pronarit, të agjencisë së pronarit dhe Supervizorit të objektit. Sipërmarrësi do të lejojë kohën e duhur në program për njoftimin dhe ekzekutimin e punimeve të shërbimeve publike siç është rënë dakord me autoritetin e duhur.

Aty ku puna e autorizuar do të kryhet nga vetë forca e punës së agjencisë, Sipërmarrësi do të koordinojë dhe lehtësojë punimet.

Sipërmarrësit i kujtohet se shërbimet publike të treguara tek skicat do të konsiderohen si tregues të shërbimeve publike në çdo vend dhe se mund të ketë të tjera prezente që nuk tregohen tek skicat.

1.15. Punë e Kryer jo-mirë.

Çdo punë që nuk përputhet me Specifikimet e Punës nuk do të merret parasysh/do të hidhet poshtë. Sipërmarrësi me shpenzimet e tij do të korrigjojë të gjitha defektet sipas urdhrit të Supervizorit.

2. KONTROLLI I CILËSISË

2.1. Përshkrimi

Kjo pjesë përshkruan kërkesat për mirëmbajtjen e cilësisë përgjatë kësaj Kontrate.

Sipërmarrësi mban përgjegjësi për cilësinë e kontrollit të ndërtimeve, materialeve, prodhimet dhe instalimet që përfshijnë Punimet. Sipërmarrësi duhet të vendosë dhe mbajë një sistem kontrolli cilësie efikas. Sistemi duhet të jetë i përshtatshëm në mënyrë që të mbulojë të gjitha veprimet dhe do të jetë çelësi i Deklaratave të Metodave të Aprovuara.

Sistemi do të konsistojë në plane, procedura dhe stafi i duhur për të kontrolluar cilësinë e të gjitha materialeve dhe produkteve të përfunduara të cilat përbëjnë Punimet në përputhje më të gjitha kërkesat e Kontratës. Sistemi do t'i përfshijë të gjitha veprimet, përfshirë këtu produktet ose fabrikimet në shesh dhe jashtë sheshit, mbledhjen e materialit mostër, testimi, inspektimi dhe menaxhimi i kontrollit për të siguruar që Puna është konform me Dokumentat e Kontratës.

2.2. Testet e çertifikuara laboratorike

Testet e laboratorëve të çertifikuar mund të bëhen nga agjenci testimi të miratuara për materiale dhe pajisje për tu përfshirë në Punime. Testet e çertifikuara për materialet që do të përfshihen në struktura do të jenë të pranueshme me kusht që ato të përdoren nga fabrikuesit, agjencitë ose laboratorët e miratuar dhe të tregojnë se materialet janë konform me Specifikimet.

2.3. Çertifikimet e fabrikuesve

Çertifikimi i fabrikuesit mund të realizohet nga Sipërmarrësi sipas artikujve të materialeve dhe pajisjeve që duhen siguruar - vetëm atëherë kur metoda do të sigurojë, sipas pëlqimit të Supervizorit, përputhje të plotë me parashikimet e Kontratës. Çertifikatat e paraprintuara nuk do të jenë të pranueshme. Të gjitha çertifikatat do të jenë origjinale.

Origjinalja e të gjithë çertifikatave të fabrikuesve ose të laboratorëve të pavarur do të emërtojnë artikullin e caktuar, pajisjet dhe materialet, specifikimet, standardet, ose dokumenta të tjera të specifikuar, si kontrollimi i cilësisë së artikujve dhe do të kenë të bashkangjitur kopje të çertifikuara të raporteve të testit sipas së cilave janë bazuar çertifikimet. Çertifikimet do të jenë të gjurmueshme për secilin produkt të prezantuar me numrin e pranueshëm të paketës, etiketat, etc.

2.4. Njoftimi për mos përfundim

Supervizori i kontrollit të cilësisë (KC) do të njoftojë Supervizorin e objektit dhe Përfaqësuesin e Sipërmarrësit për çdo mospërmbushje të dalluar me kërkesat e sipërpërmendura.

Përfaqësuesi i Sipërmarrësit me marrjen e një njoftimi të tillë do të ndërmerret menjëherë veprim korrigjues. Nëse Sipërmarrësi nuk e përmbush detyrën si duhet apo refuzon të bëjë këtë gjë, Supervizori i objektit mund të nxjerrë një urdher për të ndaluar të gjithën ose një pjesë të punës derisa të ndërmerret një veprim korrigjues i kënaqshëm. Koha e humbur nga këto urdhra ndalesash nuk do të bëhet subjekt i pretendimeve për zgjatje afati apo për kosto shtesë apo dëmtime nga Sipërmarrësi.

3. MENAXHIMI MJEDISOR

3.1. Përshkrimi

Punëdhënësi merr përsipër të mbrojë ambientin dhe të drejtojë aktivitetin e tij të përditshëm në një mënyrë ekologjikisht përgjegjëse dhe të ndalojë apo pakësojë në minimum efekte të mundshme ambientale negative lidhur me punimet.

Sipërmarrësi është i detyruar të respektojë të gjitha rregullat, politikat dhe procedurat në fjalë të ambientit përcaktuar nga ligjet dhe rregullat.

Nëse është hartuar një Plan Veprimi në Mjedis (VNM), Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë dispozitat e VNM gjatë gjithë procesit të ndërtimit.

Nëse nuk ekziston një VNM, Sipërmarrësi duhet të plotësojë totalisht kërkesat e treguara sa vijon.

Punëdhënësi rezervon të drejtën e autorizimit të pavarur të monitorimit të ambientit, i cili mund të zhvillohet gjatë gjithë periudhës së punimeve. Monitoruesit do të referojnë punëdhënësit dhe stafit inxhinierik shkelje të dukshme të kërkesave mjedisore dhe kryejnë monitorimin e tyre ditë pas dite.

3.2. Rivendosja e bimësisë (ribimësia)

Të gjitha prishjet e kodrinave, shpateve, fushave dhe çdo punim i përkohshëm duhet të rivegjetohet me bimë dhe shkurre. Në përfundim të punimeve nuk do të ekspozohen terrene të mbetura të pavegjetuara.

Ngjeshje te panevojshme të dheut/terrenit

Duhet të kryhet çdo përpjekje për të shmangur ngjeshje të panevojshme të terrenit. Në rastet kur ngjeshje të tilla janë të paevitueshme, Sipërmarrësi merr të gjitha masat e nevojshme që terreni të jetë i lirë për të gjithë thellësinë e ngjeshjes para procesit të rigjallërimit.

3.3. Mbeturinat e vajit, karburantit dhe materialeve bituminoze

Vajrat, lëndët djegëse, materialet bituminoze duhet të jenë të sistemuara dhe të vendosen në mënyrë të miratuar nga autoritetet mjedisore. Të tilla materiale në çdo rast nuk duhen eliminuar apo abandonuar.

3.4. Pluhuri

Rrugët e pashtuara lagen rregullisht me ujë për të eliminuar pluhurin e shkaktuar nga kryerja e ndërtimeve. Vadija e rregullt, në një frekuencë të mjaftueshme duhet të garantojë që sipërfaqja ku ecet të jetë gjithnjë e njomë ndërkohë që rrugët janë të zëna nga trafiku i ndërtimit.

3.5. Ngarkimi e materialeve/mbulimi

Te gjithë kamionët që transportojnë materiale te imëta apo material që mund te krijojë pluhur duhet të kenë ngarkesën e tyre të mbuluar.

3.6. Emetimet

Pajisjet për ndërtimin duhet të mbahen në mënyrë të rregullt me qëllim që të garantojnë që emetimet të jenë brenda tolerancave të prodhimit. Impiantet e asfaltit, betonit etj, duhet të pajisen me një sistem filtrimi të pluhurit dhe nuk do lejohen emetime të panevojshme të pluhurave.

3.7. Nivelet e zhurmave

Pajisje me nivel të lartë të zhurmës duhet të limitohen për të punuar nga 08:00-18:00 dhe do menaxhohen vetëm në ditët normale të punës.

Frenimi i nivelit të zhurmës mund të zbutet nga Inxhinieri nëse ai është i bindur se zona e influencuar është krejtësisht larg rrezes së dëgjimit të çdo komuniteti potencialisht të influencuar.

Niveli i lartë i zhurmës së pajisjeve karakterizohet si niveli i zhurmës më i lartë se 90db në një distancë 10 m në kushte normale pune.

Nëse është drejtuar kështu, Sipërmarrësi përdor barriera antizhurmë për të mbrojtur sektorët kritikë (shkolla etj) nga efekte të nivelit të lartë të zhurmës.

3.8. Vendosja e kampeve, hedhja e mbeturinave të kampit

Punimet përkohshme të Sipërmarrësit (kampe, gurore, gropa, pirqje, grumbuj hekurishtesh duhet të vendosen vetëm me aprovimin e autoriteteve.

Kampet në veçanti duhet të kenë çdo aspekt të shërbimit të heqjes së mbeturinave qartësisht të përcaktuar dhe të aprovuar.

Gjatë kryerjes së punimeve të përkohshme Sipërmarrësi duhet të sigurojë që mbeturinat e materialeve të të gjitha llojeve, të transportohen dhe të hidhen vetëm me mjete të miratuara

3.9. Habitata të papërshtatshme/të padëshirueshme

Vektori ekologjik duhet të vlerësohet dhe kontrollohet në të gjithë sektorët e punimeve dhe krijimi i habitateve të papërshtatshme (p.sh. uji i ndenjtur) nuk duhet të lejohet.

3.10. Materiale të rrezikshme

Të gjitha materialet e rrezikshme (përfshirë karburante, vajra, materiale bituminoze, çimento) do të mbahen në vende me mbrojtje të plotë nga rrjedhjet apo nga shpërbërja. Të gjitha mbeturinat apo

materialët e mbetura duhet të hidhen duke përdorur procese të miratuara, të cilat garantojnë të mos shkaktojnë efekte të sëmundjeve mjedisore.

3.11. Bimësia

Sipërmarrësi në çdo moment duhet të marrë në kohë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar shkatërrimin e pemëve dhe bimësisë. Duhet të sigurojë që personeli tij në çdo kohë të mos marrë përsipër prejen e paautorizuar të pemëve apo bimësisë.

3.12. Aksesit në pronë

Të gjitha hyrjet e pronave ekzistuese duhet të respektohen në çdo moment të zbatimit të punimeve. Kudo që pronë ka një hyrje ekzistuese Sipërmarrësi duhet të sigurojë përmes kryerjes së punimeve të përshtatshme që kjo hyrje të mbetet në dispozicion të pronarit të pronës gjatë punimeve.

4. PASTRIMI I KANTIERIT

4.1. Hyrje

Ky paragraf i punës konsiston në heqjen, lëvizjen, pastrimin e ndërtimeve ekzistuese, themeleve dhe ndërtimeve përkatëse duke përfshirë rrugët, bimësinë, rrethimet, rezervuarët, kanalet e kullimit etj, heqjen e gjithë bimësisë së konsiderueshme që përfshin shkurre etj, pastrimin dhe shkuljen përgjatë gjithë zonës të prekur nga punimet.

4.2. Kërkesa të Përgjithshme

a. Të Përgjithshme

Supervizori i objektit do të identifikojë dhe krijojë limitet e punës dhe do të planifikojë/projektojë që pemët, shkurret, bimët dhe bimësia tjetër të rrijë në ekzistencë. Sipërmarrësi do të mbrojë dhe do të kujdeset për të gjitha sendet që nuk janë menduar të lëvizen/hiqen.

b. Pastrimi i mbetjeve

Te gjithë mbeturinat ekzistuese të bëra nga njeriu apo natyra, do të hiqen nga vendi i punës dhe do të hidhen me aprovim të Supervizorit të objektit para fillimit të punimeve të përkohshme apo të përhershme në zonë.

c. Pastrimi dhe shkulja e Bimësisë

Kjo punë do të përfshijë heqjen nga vendi i punës të gjithë bimësisë që i kalon kufijtë, sipas udhëzimeve të Supervizorit të objektit. Pastrimi i bimësisë do të kufizohet në përgjithësi tek një maksimum dimensionit të barabartë me shtrirjen e propozuar të punimeve. Përtej kësaj pike, bimësia ekzistuese do të rrijë e patrazuar.

Trungjet e pemëve dhe sistemet e rrënjëve do të mbesin në linjën e veprimit të Supervizorit të objektit; në përgjithësi ato do të rrinë të pa hequra.

d. Pastrimi i tombinove, kolektorëve ekzistues

Kjo punë do të përfshijë heqjen e rërës, llumit dhe mbetjeve të tjera të depozituara në sistemet e kanaleve ekzistuese (kanal nën rrugë), siç udhëzohet nga Supervizori i objektit. Materiali do të hiqet në përputhje me kërkesat e përgjithshme të këtyre specifikimeve dhe në rast materialeve toksike apo të rrezikshme - në përputhje me ligjet e shtetit, planit të menaxhimit mjedisor apo kërkesave të këtij specifikimi.

Sipërmarrësi do të pastrojë pjesën e brendshme të tubit dhe pusëtën e kanalit nënrrugor në mënyrë që të riparohet linja origjinale e tyre. Kontraktuesi duhet të sigurojë që kanalet anësore dhe të gjitha pikat e futjes nga dhe tek, tubat e lidhur me këtë dhe kanalet nënrrugore të jenë të pastra nga ndotja, balta, llumi dhe materiale të tjera të ngjashme, të cilat ndalojnë rrjedhjen e lirë të ujit.

e. Pastrimi i shtresave të punueshme

Në zonat e gërmimit ose diku tjetër ku thuhet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të heqë

shtresat ekzistuese sipas zërave të punimeve. Materiali do të ruhet për ripërdorime të tjera ose do të hidhet sipas udhëzimeve.

Heqja e shtresave të punueshme mbi ndonjë zonë të projektuar do të ekzekutohet në thellësi siç udhëzohet nga Supervizori i objektit dhe shtresat e punueshme do të ruhen dhe do të mbahen veçmas nga materialet e tjera të gërmuara. Në përgjithësi, shtresa e punueshme e ruajtur do të përfshijë vetëm atë pjesë të materialit që është mjaftueshëm pjellor për të inkurajuar ose nxitur rritjen e bimësisë.

Në përgjithësi, e gjithë shtresa e punueshme e gërmuar do të përdoret për veshje të ardhshme të gropave, apo zonave të tjera siç mund të udhëzohet nga Supervizori i objektit ose siç tregohet tek skicat. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës, duke mirëmbajtur këto vende punimesh gjatë kohëzgjatjes së punimeve dhe duke i bërë ata ti përmbahen standardeve të aprovuara.

4.3. Mbrojtja e elementëve që janë projektuar të rrijnë përsëri

Në zonat e caktuara nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për mbrojtjen e shkurreve ekzistuese, pemëve dhe sipërfaqeve me bar. Me mbarimin e punimeve këto zona do të rikthehen Punëdhënësit në të njëjtat kushte si me parë dhe ndonjë dëm si pasojë direkte apo indirekte e veprimeve të Sipërmarrësit nuk do të jetë kosto shtesë e Punëdhënësit.

Pemët e projektuara për të qëndruar brenda zonës së punimeve, do të mirëmbahen, mbrohen dhe do të lihen të qëndrojnë.

Të gjitha kalimet ekzistuese të këmbësorëve, trotualet, rrethimet, muret, pemët, shkurret, lulishtet, apo të tjera të përcaktuara nga Supervizori i objektit nuk do të hiqen dhe duhet të merren masa dhe të ruhen nga dëmtimi. Çdo dëmtim që ndodh si pasojë e dështimit të Sipërmarrësit për të marrë masat e duhura paraprake, do të riparohet me shpenzimet e Sipërmarrësit.

Artikujt/sendet e pronës private do të mbesin në vend (ndërtesa, rrethime, kanale kullimi, ujitjeje, ujë, kanale, vrime, mure, kryqëzime kanalesh, etj) do të mbrohen me kujdes nga dëmtimet dhe zhvendosjet.

4.4. Grumbullimi i materialeve të pastruara

1. Pronësia e materialeve

Përveç nëse kërkohet ndryshe në kushtet e kontratës, të gjitha materialet e hequra nga Sipërmarrësi janë në pronësi të Bashkisë dhe Sipërmarrësi do të dorëzojë ose vendosë ato në vendin e caktuar nga Bashkia, në përputhje me kërkesat e ligjit të shtetit, planit të menaxhimit mjedisor, kërkesat e këtij specifikimi dhe instruksionet e Supervizorit të objektit.

3. Hedhja ne zona afer Objektit

Materialet mund të hidhen në një pronë private duke u siguruar nga Supervizori i objektit që ai ka një aprovim të shkruar nga pronari i pronës i cili jep lejen për hedhjen e materialeve. Të gjitha zonat e hedhjes së materialeve që rezultojnë nga pastrimi dhe shkulja, qoftë në pronë private apo në pronë të poseduar nga Sipërmarrësi, do të jenë në zona larg pamjes së Objektit dhe të pakten 100m larg nga kufiri i rrugës më të afërt të automjeteve. Nëse materialet do të digjen, duhet një dimension zone prej 100m. Në asnjë mënyrë kjo masë nuk heq përgjegjësinë e Sipërmarrësit për të hedhur materialet në përputhje me ligjet e shtetit, planin e menaxhimit mjedisor dhe me kërkesat e këtij specifikimi.

4. Nivelimi i terrenit

Brenda çdo zone mes kufijve të ndërtimit dhe kufijve të jashtëm të pastrimit dhe shkuljes, të gjitha gropat dhe boshllëqet e tjera do të mbushen dhe të gjitha pirgjet prej dheu do të sheshohen. Zonat do të sillen në kontur unifom në mënyrë që mbushja dhe sheshimi vijues të mos pengohen nga parregullsia e terrenit. Kjo punë do të bëhet pavarësisht nëse parregullsitë janë rezultat i aktivitetit të Sipërmarrësit apo ishin ekzistente në mënyrë origjinale. Pellgjet apo zonat e tjera ujore, të projektuara si të tilla, nuk do të kërkohet që të mbushen.

5. SHKATERRIMET, PRISHJET, ÇMONTIMI DHE HEQJET

5.1. Hyrje

Shkatërimi dhe heqja e strukturave, mbetjeve ekzistuese etj, nga Sipërmarrësi do të kryhet brenda vendit të punimeve siç udhëzohet nga Supervizori i objektit dhe siç tregohet tek vizatimet.

Të gjitha materialet me vlerë ripërdorimi nga puna e çmontimit janë dhe do të mbeten pronë e Bashkisë. Sipërmarrësi do ti dorëzojë ato në vendin e caktuar nga Bashkia me shpenzimet e tij. Tërë mbeturinat e dala nga prishjet dhe shkatërimi do të depozitohen në vendin e caktuar nga Bashkia.

Sipërmarrësi do të jetë totalisht përgjegjës për heqjen dhe hedhjen në përputhje me ligjet e shtetit, planit të menaxhimit mjedisor dhe kërkesave të këtij specifikimi, të të gjithë materialeve që dalin nga shkatërimet.

5.2. Hedhja e materialeve

Përveç sa është përshkruar më sipër, i gjithë materiali i mbetur (mbeturinat) do të hidhet nga Sipërmarrësi në zona të siguruara prej tij dhe të miratuara nga Supervizori i objektit. Çdo material i planifikuar për të mbetur pronë e Bashkisë, ose do të grumbullohet në grumbuj të pastër ose do të ngarkohet dhe do të transportohet tek zonat e planifikuara për ruajtje. Sipërmarrësi inkurajohet të bashkëpunojë me autoritetet vendore në përcaktimin e përdorimeve të mundshme për ndonjë material të hedhur dhe në ngritjen e zonave të ruajtjes.

6. PUNIMET NË RRUGË

6.1. Qëllimi

Ky seksion përmban përcaktimet e përgjithshme dhe kërkesat për punimet në rrugë.

6.2. Gjermim dheu seksion i detyruar:

Gjermim dheu për trupin e rrugës, deri në thellësinë 50, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të tharë ose të lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.), përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve dhe pjesëve me volum deri në 0,30 m³, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrave të zeza, të bardha ujësjellësit, të elektrikut etj.

6.3. Ndërtim bankina anësore:

Ky zë përfshin të gjitha proceset dhe materialet që duhen për ndërtimin e bankinës uniforme me trashësi 15 cm të çakullit. Në të përfshihet kostoja e blerjes së materialit, furnizimi, transporti, depozitimi dhe shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5–6 kalime vajtje ardhje deri në ngjeshje 98%. Çakulli duhet të jetë nga thyerja e gurit të kavos me granulometri 5/40 mm, të bëhen provat e materialit për plotësimin e kushteve teknike për materialin që përdoret dhe më pas të lajmerohet Supervizori. Vetëm pas miratimit me shkrim nga Supervizori do të lejohet përdorimi i materialit të çakullit për bankinat. Çmimi i referohet 1 m² shtresë me çakull 1x15 m, gran.5/40 mm.

6.4. Gjermim dheu seksion i lirë:

Ky çmim përfshin tërësinë e punorisë dhe punimeve që lidhen me gjermimin për profilimin e trupit të rrugës, pamvarësisht nëse ky gjermim bëhet me krahë, me makineri apo me mina, në prezencë apo jo të ujit, në seksion të detyruar apo jo, në tokë të fortë apo të butë, zhavorr, beton apo asfalt. Gjithashtu këtu duhet të futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit në vendet e autorizuar nga bashkia të materialeve që dalin nga gjermimi. Ky çmim i referohet 1m³.

6.5. Mbushje me material shkëmbor:

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe punorisë që lidhen me mbushjen me material shkëmbor për profilimin e trupit të rrugës dhe të trotuareve në thellësinë e dhënë në profilat tërthorë të projektit me shtresa çdo 20 cm, grejderimin dhe rulimin në lageshtirë të këtij materiali. Gjithashtu

këtu futet dhe kostoja e blerjes/prodhimit, ngarkimit, transportit, shkarkimit, të materialeve të nevojshme. Ky çmim i referohet 1m³.

6.6. Shtresë zhavori nën kunetë:

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe puntorisë që lidhet me blerjen e zhavorit, hedhjen e tij në shtresa me $t = 10$ cm, nën kuneta ku të kihet kujdes që të respektohet granulometria dhe dhënia e pjerrësisë dhe çdo gjë tjetër e nevojshme. Po këtu duhet të futet edhe kostoja e ngarkimit, transportit, shkarkimit në objekt të zhavorrit. Ky çmim i referohet 1 m².

6.7. Beton M-200 për kunetë:

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe puntorisë që lidhet me blerjen e betonit ose të materialeve dhe prodhimin e betonit M-200 për kunetën, gërmimi i seksionit ku do të hidhet kuneta, ngarkimin, transportin, shkarkimin, hedhjen në vepër, përgatitjen e armaturës së dërrasës, vibrimin e tij, të gjitha këto konform vizatimit tip shoqërues në projekt. Betonet duhet të jenë me dozim sipas pikës I.a.3. Ky çmim i referohet 1 m³.

6.8. F.V Bordura betoni të Parapërgatitura 15x30x100 cm:

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe puntorisë që lidhen me prodhimin/blerjen e bordurave të betonit M-200 të parapërgatitura me përmasa 15x30x100 cm që vendosen anës rrugës për të kufizuar trotuarin nga rruga, përfshin gërmimi për vendosjen e tyre, vendosja e tyre në vepër dhe çdo gjë tjetër e nevojshme. Gjithashtu këtu futet edhe kostoja e blerjes, ngarkimit, transportit, shkarkimit, të materialeve të tjera të nevojshme (armaturë dërrase apo metalike, rërë, çimento, granil e tjera. Bordurat duhet të jenë të stazhonuara mirë. Ky çmim i referohet 1 ml.

6.9. Beton M-100 nën bordura e tubat e betonit :

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve dhe të puntorisë që lidhen me blerjen/përgatitjen betonit M-100 sipas dozaturës të dhënë në pikën I.a.1, hedhjen në vepër nën anash bordurave dhe nën tuba, të gjitha këto konform vizatimit tip shoqërues në projekt, ngarkimin, transportin, shkarkimin e materialeve (rërë e larë, granil i larë, çimento, dhe çdo gjë tjetër të nevojshme). Ky çmim i referohet 1 m³.

Punime Shtresash në Rrugë

6.11. Shtresë çakulli makinerie, 15cm/20cm , gran.10/60 mm, 5/50 mm:

Ky zë përfshin tërësinë e punimeve që lidhen me shtresën e çakullit, 1x15 cm me qëllim përforcimin e trupit të rrugës në drejtimin tërthor dhe gjatësor sipas profileve përkatëse të projektit si dhe rulimin dhe ngjeshjen e shtresës së çakullit deri në densitet 95%. Për shkak të gjendjes jo uniforme të sipërfaqes egzistuese të rrugës, në tërë sipërfaqen është parashikuar përdorimi i grejderit me qëllim përpunimin më të mirë të sipërfaqes së rrugës dhe rulimi i shtresës me rul 10-12 ton me 5–6 kalime vajtje ardhje.

Granulometria duhet të jetë jo më shumë se 10/60 mm, 5/50 mm, çakulli që do të përdoret duhet të miratohet paraprakisht me shkrim nga Supervizori. Ky material duhet të plotësojë kushtet teknike për qëllimin e përdorimit dhe të mos ketë më shumë se 5% argjila. Ky çmim i referohet 1m².

6.12. Shtresë stabilizanti 1x10cm, gran.5/35mm:

Ky zë përfshin të gjitha proceset dhe materialet që duhen për ndërtimin e shtresës uniforme me trashësi 10 cm të stabilizantit, pas përfundimit të shtresës paraardhëse të themelit të rrugës. Në të përfshihet kostoja e blerjes së materialit, furnizimi, transporti, depozitimi shtrimi dhe nivelimi me grejder dhe cilindrimi me 5–6 kalime vajtje ardhje deri në ngjeshje 98%. Stabilizanti duhet të jetë nga thyerja e gurit të kavos me granulometri 5/35 mm, të bëhen provat e materialit që përdoret për plotësimin e kushteve teknike, për materialin që do të përdoret të lajmërohet Supervizori. Vetëm pas miratimit me shkrim nga Supervizori do të lejohet përdorimi i materialit të stabilizantit. Çmimi i referohet 1m².

6.13. Shtresë binderi me trashësi 4 cm:

Ky çmim përfshin koston për blerjen e materialit, furnizimin, shpërndarjen e binderit në një shtresë uniforme me trashësi 4cm dhe cilindrimin e tij, pas përfundimit të shtresës uniforme e ngjeshur dhe profiluar mirë dhe sipas projektit e stabilizerit në të gjithë sipërfaqen e rrugës me makineri, si dhe pastrimi nga papastërtitë e mundshme që të realizohet bashkimi i saj me shtresën e re. Para shpërndarjes së binderit duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e binderit duhet të jetë e tillë që të sigurojë pas rulimit trashësinë minimale të përcaktuar në projekt (4 cm). Shtrimi duhet të bëhet me makinë asfaltoshtruese. Binderit në objekt duhet të ketë granulometrinë, temperaturën dhe konsistencën e duhur. Pas shpërndarjes binderit duhet të rulohet duke krijuar një sipërfaqe konform prerjes tërthore dhe pjerrësive të dhëna në projekt. Pas rulimit bëhet pastrimi i sipërfaqes së rrugës nga mbeturinat. Anët e shtresës së binderit duhet të realizohen me anë të drejtuesve për të ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave në kthesa. Në këtë çmim futet dhe çdo gjë tjetër që lidhet me këtë operacion. Çmimi i referohet 1 m².

6.14. Shtresë asfaltbetoni me trashësi 4cm:

Ky çmim përfshin koston e blerjes së materialit, furnizimin, transportin, shpërndarjen dhe rulimin e asfaltobetonit në një shtresë me trashësi 4 cm. Paraprakisht duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes nga të gjitha mbeturinat. Para shpërndarjes së asfaltobetonit duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqes me prajmer 0,5 litra/m². Sasia e asfaltobetonit duhet të jetë e tillë që të sigurojë pas rulimit trashësinë uniforme minimale të përcaktuar në projekt (4cm). Asfaltobetonit në objekt duhet të ketë granulometrinë, temperaturën dhe konsistencën e duhur. Pas shpërndarjes, asfaltobetonit duhet të rulohet duke krijuar një sipërfaqe konform prerjes tërthore dhe pjerrësive të dhëna në projekt. Shtrimi duhet të bëhet me makinë asfaltoshtruese. Pas rulimit bëhet pastrimi i sipërfaqes së rrugës nga mbeturinat si dhe pastrimin e mbetjeve të asfaltobetonit mbi kunetën e betonit për të realizuar një vijë të dukshme. Në këtë çmim futet dhe çdo gjë tjetër që lidhet me këtë operacion. Anët e shtresës së asfaltobetonit duhet të realizohen me anë të drejtuesve për të ruajtur linearitetin e tyre si dhe rrezet e kurbaturave në kthesa. Çmimi i referohet 1 m².

7. PUNIMET PER LINJAT REZERVE

7.1. Te pergjithshme

Tubat e PVC-se per linjat rezerve do jene me dimension D=160mm dhe D=110mm me spesor d=3mm.

Tubat do te furnizohen ne komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme. Kanalet e tubacioneve jane pershkruar ne kapitujt e tjere. Pervец se modifikuar ose shtuar si ketu, te gjitha tubat PVC do te plotesojne standardet kombetare dhe nderkombetare, konform karakteristikeve teknike Sipas EN 13476, EN 1610, EN1183, EN1133, EN527

Cdo tub duhet te kete te shenuar ne te ne menyre permanente te dhenat me poshte:

Daten e prodhimit Emrin e prodhuesit

Shenimi duhet te jete i trpezuar ne tub ose i shkruar me boje rezistente ndaj ujit.

7.2. Shtrimi ne kanal

Tubacionet e PVC-se do te shtrohen ne kanale ne thellesi e cila jepet ne projekt

Seksioni i kanalit do te hapet sipas permasave te dhena ne projekt ne raport me thellesine dhe dimensionin e tubacionit.

Tabani i kanalit duhet te jete i sheshte pas germimit. Ne qofte se nga germimi me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krahe.

Para vendosjes se tubacioneve do vendoset nje shtrese granili i imet (0.5cm) me trashesi 10-15cm. Granili do nivelohet ne perputhje me kuotat e projektit. Pas shtreses se grailit do montohet tubacioni sipas dimensioneve te dhena ne planimetrine perkatese dhe me pas do behet mbulimi i tij me granil 10cm mbi kuroren e tubit. Mbi te do behet mbushje me cakell me shtresa me trashesi 25cm. Shtresat do ngjeshen duke i shoqeruar me sperkatje me 14je. Mbushja do behet deri ne kuaten ku fillojne

shtresat e shetitores. Ne zonat ku vendosja e tubave PVC diktohet te jete jo ne thellesi sipas projektit si dhe ne zonat ku intersekon rruge, per mbrojtjen e tyre do perdoret veshje me beton C10/15.

Per arrijten e shtrimit te tubave PVC ne perputhje me standartet duhen marre keto masa;

- perdorimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhurnimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

7.3. Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdorimi i sakte i tyre

Mjetet e permendura me poshte duhet te jene ne nje numer te mjaftueshem ne kantier

Veglat TYTON, lubrifikante, mjete prerese

Vegla TYTON perdoret per pastrimin e gotave, dhe kontrollimin per mbeshtetjen si duhet te gomines TYTON pas gotes.

Lubrifikant per TYTON dhe lidhje standarte

Mjete prerese

Per prerjen e tubave prej PVC-je, disqe abrazive prerese jane pare si me te pershtatshmit.

Prerese me gur zmeril dhe flete sharre mund te perdoren

7.4. Instruksionet e montimit

Hapat qe duhen bere perpara montimit:

Tubat prodhohen ne gjatesi 6.0m (mund te behen eshte porosi te vecanta). Mund te priten kudo, midis bordurave, me sharra te zakonshme druri (dore ose mekanike, por jo me sharre zinxhir). Buza e prerjes pastrohet me lime druri ose vegla te tjera ferruese.

Shtrimi fillon nga pika ku do jete puseta. Kupa eshte mire te vihet ne drejtimin ngjites (Siper). Buza e tubit dhe kupes duhen pastruar me kujdes.

Mbas kesaj siperfaqja e brendeshme e kupes lyhet solución ngjites, e me pas tubi shtyhet brenda kupes me me dore deri sa te takoje fundin e gotes. Nuk duhet terhequr mbrapsht fundi i tubit.

7.5. Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone

Tubat PVC do te mbahen me kujdes gjate gjithë kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe montimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdesshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat me brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqsores te bashkimeve do te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi. Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate montimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

7.6. Germimi

Germimi per linjat rezerve do te jene sic jane specifikuar ne Seksionin (Punime Dheu) te ketyre specifikimeve teknike.

7.7. Ndertimi i pusetave

Sipermarresi do te ndertoje puseten ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates, ose sic udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve. Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektimin dhe punime dhe do te jene vendosur ne pika ku jane percaktuar me projekt.

Bazamenti dhe muret e pusetave do te ndertohen me Beton C20/25. Hapja e vrimave ne mure mbas ndertimit nuk do te lejohet.

Pasi hapet gropa e pusetes, toka duhet te pergatitet ne menyre qe te siguroje themele te pershtateshme. Per kete arsye toka poshte bazamentit te pusetes do te kompaktesohet. Mbi te do te krijohet nje bazament i pershtateshem me zhavorr dhe beton M – 100.

Zona perreth pusetes nuk mund te mbushet menjehere pasi puna per mbushjen duhet te behet kur suvaja te jete perfunduar. Nqs puseta eshte ndertuar ne nje rruge te pambaruar korniza e hekurit dhe kapaku mbulues nuk vendosen ne pusete, ndersa nje pllake çeliku vendoset siper pusetes derisa rruga te asfaltohet.

Kapaket dhe kornizat do te jene me hapesire drite 100x100cm siç eshte treguar ne vizatime. Kapaku do te perbehet nga dy pjese perkatsisht 100x50cm te hapshme secila. Kapaku do mbeshtet teresisht ne telajo dhe midis tyre duhet te vendosen gominat perkatese per amortizim. Kapaket duhet te jene te paisura me doreza per te mundesuar hapjen e tyre si dhe celesa per hapjen dhe mbylljen e tyre.

Kapaket do te vendosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se shetitores ne kuote te njejte me shtresen e gureve. Kapaku do te jete per ngarkesa >400MPa. Telajo dhe kapaku do jene te galvanizuara sipas EN ISO 1461, kategoria D 400, testuar sipas EN 124. Telajo dhe Kapaku duhet te jene te prodhuara ne fabrika te specializuara per prodhimin e tyre. (nuk duhet te pranohet prodhim artizanal i tyre). Telajo do jete e fiksuar ne kapakun betonarme te pusetes. Kapaku do kete thellesi min 10cm per vendosjen e dekorit te gureve me Beton C30/37. Ai duhet te kete doreze per te mundesuar hapjen.

7.8. Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet

Kosto e gemit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e cmimeve njesi qe lidhen me keto punime.

Furnizim i tubacioneve te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia puntore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktiviteteteve sic pershkruhen me siper jane perfshire ne cmimin njesi per nje meter tubacion kanalizimesh.

Matja: Linja e qendres se tubave PVC do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusetes pasuese pergjate aksit te tubit.

Tubot e korruguara DN 200 dhe DN 300 duhet të jenë me gjithë elementet bashkues dhe guarnicionet.

-Me DN është shënuar diametri i brendëshëm i tubit.

-Për lidhjen e shtëpive dhe pusetave të shiut me tubo pvc 160, do të përdoren dhe vendosen rakorderi dhe guarnicione bashkues .

7.9. Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

Cmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e cimentos, inerteve, ujit, armimit shtratimit, aramturat, forcimi i bazamentit te pusetes, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, suvatimi i bashkueseve me llac cemento, perzierja dhe hedhja e betonit, bankinat, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te pusetave dhe sheshimi i siperfaqes perreth, ngritja e materialeve duke perfshire por jo kufizuar furnizimin e te gjitha materialeve, paisjeve, veglave dhe fuqise puntore, si dhe, ngarklimin, transportin dhe shkarkimin e mbulesave te pusetave, furnizimin dhe vendosjen e kapaku te galvanizuar me dekor guri te montuar mbi te.

Matja: Matjet do te bazohen ne numrin e pusetave te ndertuara. Thellesia eshte distanca vertikale ndermjet niveli te tokes dhe kuotes se projektit.

8. PLLAKAT

8.1. Të përgjithshme

Ky seksion mbulon kërkesat dhe procedurat për shtrimin e trotuareve, që parashikohet të ndërtohen sipas kërkesave të Kontrates.

8.2. Materialet - pllaka betoni vetështrënguese

Pllakat e betonit duhet të prodhohen në fabrika të specializuara për prodhimin e tyre.

Sipas specifikimeve teknike ato duhet të plotësojnë një sërë kërkesash:

Spresori (trashesia)	6cm
Përdorimi	Këmbësorë
Pesha specifike	>2200 kg/m ³
Rezistenca në shtypje	>500 kg/cm ²
Përshkueshmëria nga uji	<12%

Pllakat duhet të jenë të prodhuara me dy shtresa.

Shtresa 1 – Shtresa e Poshtme, përbën 88% të volumit të pllakës dhe do jetë e prodhuar në presa me presion dhe vibrim për të garantuar Markën e Betonit dhe uniformitetin. Betoni i prodhuar duhet të jetë i Klasës A-A, i përgatitur me inerte të fraksionuara me granulometri 0-8mm dhe çimento Portland e rezistueshme.

Shtresa 2 – Shtresa e Sipërme, përbën 12% të volumit të pllakës (spesorit) realizohet me inerte të fraksionuara me granulometri 0-5mm, oksid hekuri dhe çimento Portland e rezistueshme.

Pllakat duhet të jenë të prodhuara me sipërfaqe të ashpër (për të evituar rrëshqitjen) dhe të rezistueshme ndaj ngricave edhe kripes.

Sipërmarresi duhet të sigurojë fletanalizen e provave për pllakat që do të përdoren. Asnjë material nuk do të përdoret nga Sipërmarresi pa miratimin e Supervizorit të punimeve

8.3. Shtrimi

Shtrimi me pllaka betoni vetështrënguese

Shtrimi me pllaka do të jetë shtresa perfundimtare e objektit. Shtrimi do të bëhet me urdher me shkrim nga Supervizori i objektit pas verifikimit të cilësive dhe nivelit të vendit ku do të kryhet shtrimi. Fillimisht do të pastrohet dhe do të laget me ujë, vendi ku do të kryhet shtrimi. Hidhet shtresa e llaçit dhe nivelohet. Më pas kryhet vendosja e pllakave sipas dekorit të dhënë në projekt dhe ngjeshja e tyre në mënyrë që të fiksohen në shtresën e llaçit. Materialet duhet të jenë komform kushteve teknike dhe standarteve në fuqi. Shtresa duhet të ketë trashesinë e përcaktuar në projekt mbas nivelimit dhe ngjeshjes. Shtrimi dhe ngjeshja me kompaktor duhet të ruajë pjerresite gjatesore dhe terthore sipas detajeve të projektit.

Gjate shtrimit kontraktori duhet të marrë tërë masat për purputhjen e pllakave në plan dhe lartësi në mënyrë që të krijojë një sipërfaqe sa më uniforme.

Sipërmarresi do të kryejë të gjitha punimet ndihmëse, si pastrimi para dhe pas shtrimit, nivelimi, rakordimi në zonat e caktuara.

Sipërmarresi do të mbrojë gjithë kohën shtresat e pllakave nga demtimet. Cdo demtim gjatë periudhës së punimeve do të riparohet menjëherë.

8.4. Provat

Para shtrimit të sipërfaqeve Sipërmarresi duhet të bëjë provat e pllakave për cilësi. Kampionet do të perzgjidhen nga Supervizori. Frekuenca e provave do të jetë

Rezistenca në shtypje	– cdo 500m ²
Rezistenca në Perkulje	– cdo 500m ²
Absorbimi	– cdo 1000m ²
Abrasioni	– cdo 1000m ²

Tolerancat për pllakat:

Tolerancat e lejuara për dimensione +/-2 mm. Tolerancat e lejuara për montim +/-3.

8.5. Matjet dhe pagesat

Pagesa për punimet e specifikuara në këtë seksion të Specifikimeve do bëhet për metër katror të shtruar në vlerën për metër katror që është parashikuar në Preventiv sipas secilit zë, përfshihet montimi me llac çimento, mbushja e fugave, pastrimi para dhe pas shtrimit si dhe pastrimi përfundimtar.

9. BETONI

9.1. Përshkrim

Ky seksion mbulon materialet, projektimin e miksurave, perzieresin, transportin, vendosjen, konsolidimin dhe kurimin e betonit që kërkohej për Punimet.

9.2. Materialet për Beton

Te pergjithshme

Sipermarresi do i paraqese Supervizorit te objektit gjithe detajet mbi gjithe materialet qe ai propozon per te shfrytezuar ne pergatitjen e betonit. Keto detaje do perfshijne llojin e kategorine e materialit, duke perfshire standartin apo specifikimin, burimin e materialit te marre, (impiantin, guroren, apo te tjera) etj., te gjitha ne perputhje me kerkesat e specifikimeve ne fjale. Materialet e nderthurura ne beton do certifikohen nga burimi qe jane marre dhe do jene konform me gjithe kerkesat e specifikimit.

Asnje beton nuk do te vendoset deri sa Supervizori Objektit ka aprovuar materialet me te cilat eshte kompsuar. Materialet e aprovuara nuk do te alternohen ose zevendesohen me materiale te tjera pa miratimin me shkrim te Supervizorit te objektit.

10. BORDURAT

10.1. Pershkrim

Te ndertohet nje kontur me bordure guri qe do kufizojte rrugen ne pozicionet qe eshte treguar ne vizatime apo sic drejtohet nga Supervizori i objektit.

Bordurat do jene konform me pershkrimet dhe perkufizimet e shumta qe rrjedhin nga Vizatimet.

10.2. Materialet per bordurat

Bordura Guri do te jene te prodhuara me permasa:

Bordure tip 15x30x(variabel) (cm) për bordurat në rrugë

Montimi i tyre do te behet me beton C10/15

Punoi:

Urbaniste

Zhaneta LUBONJA